



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03, prill 2019), të nenit 29, të Rregullores nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme, dhe në bazë të nenit 33.2, shkronja **a** dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 01. 046-157056, TË DT. 27.08.2013, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE

- I. **MIRATOHET** Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.046-157056, i dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private të New company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim - ndryshimi nënkupton, si në vijim:
 - I. Ndryshohet pika II e vendimit, gjegjësisht paragrafi 1, ku është përshkruar këmbimi i New company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka, të shtohet pjesa e parcelës kadastrale nr. 07206-1, Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07206-1, në pronësi të Komunës së Prishtinës.
- III. Propozimi për inicimin e plotësim-ndryshimit të Vendimit të cekur në pikën II, është bërë pasi që Vendimi nr. 01.046-157056, dt. 27.08.2013, nuk mund të ekzekutohet, për arsye se prona private e cila merret me vendimin e lartcekur, ka sipërfaqe të madhe dhe sipas vlerësimit nga organi kompetent, prona e Komunës e dhënë sipas vendimit për këmbim ka sipërfaqe të vogël. Për të bërë barazimin e pronës sipas vlerësimit duhet të shtohet parcela e cekur më lart.
- IV. Ekzekutimi i këtij vendimi dhe lidhja e kontratës së këmbimit nuk do të bëhet deri në momentin që palët hekin dorë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe procedurave të përmbarrimit në lidhje me kompenzimin e pronave të cilat janë objekt i këtij këmbimi.
- V. Pikat tjera të Vendimit, nr. 01.046-157056, dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private mbesin të pandryshuara.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 26.08.2013, ka miratuar Vendimin nr. 01.046-157056, dt. 27.08.2013, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private.

Drejtoria e Pronës, ka dërguar vendimin për vlerësim te organi kompetent. Pas pranimit të akteve të vlerësimit nga Ministria e Financave, Departamenti i Vlerësimit, është konstatuar se vendimi nr. 01.046-157056, dt. 27.08.2013, nuk mund të zbatohet, sepse prona private e cila merret me vendimin lartcekur, ka sipërfaqe të madhe dhe sipas vlerësimit nga organi vlerësues, prona e Komunës e dhënë sipas vendimit për këmbim ka sipërfaqe të vogël, andaj për të bërë barazimin e pronës sipas vlerësimit duhet të shtohet parcela e cekur më lart.

Propozimi për inicimin e plotësim-ndryshimit të vendimit të cekur më lart, sipas propozimit të cekur në pikën I të këtij propozimi, është bërë pasi që Gjykata Supreme e Kosovës, sipas Aktvendimit, Rev.nr. 154/2021, dt.24.05.2021, ka vendosur në favor të pronarëve të pronës private, andaj ka obliguar Komunën e Prishtinës që të bëjë kompensimin e pronës private të shfrytëzuar për interes publik. Pasi shuma e kompensimit dhe e kamatave është shumë e lartë, është kërkuar të bëhet plotësimi i vendimit të lartcekur dhe më pas të realizohet këmbimi i pronës komunale me pronë private.

Plotësim-ndryshimi i vendimit të lartcekur nënkupton: ndryshohet, plotësohet pika II e vendimit, gjegjësisht paragrafi 1, ku është përshkruar këmbimi i New company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka, të shtohet pjesa e parcelës kadastrale nr. 7206-1, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet plotësim-ndryshimi i vendimit sipas pikës I të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikata e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112344/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

